



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të nenit 32, pika 32.1, shkronja e të Statutit të Komunës së Prishtinës, të dt. 31.3.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 25.6.2008, merr

**V E N D I M**  
**PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË QENDRËS SË**  
**MJEKËSISË FAMILJARE NË LAGJEN “VELANIA” NË PRISHTINË**

**Neni 1**

- 1.1 Miratohet vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës së Mjekësisë Familjare në lagjen “Velania”, në Prishtinë.
- 1.2 Lokacioni, nga paragr. 1 i këtij neni, përfshinë pjesët e ngastrës kadastrore nr. 2551 dhe 2559/1, në sipërfaqe prej 0.15.00 ha, Zona kadastrore – Prishtinë.

**Neni 2**

Ndërtimi i objektit, sipas këtij Vendimi, do të bëhet në bazë të programeve dhe përmbajtjeve tjera të nevojshme për objekte me destinim të këtillë, të hartuara nga organet kompetente të Komunës së Prishtinës.

**Neni 3**

- 3.1 Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Këshilli i Drejtorëve i Komunës së Prishtinës.
- 3.2 Nga aspekti i realizimit të lokacionit do të kujdeset Drejtoria e Urbanizimit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ndërsa nga aspekti i realizimit të objektit do të kujdeset Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale e Komunës së Prishtinës.
- 3.3 Sektori i kadastrit do t'i kryejë veprimet procedurale të nevojshme nga përgjegjësia e tij për zbatimin e këtij Vendimi.

**Neni 4**

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është edhe pjesa tekstuale dhe grafike e situacionit të lokacionit të nenit 1 të këtij Vendimi.

**Neni 5**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01 Nr.353-862, më 25.6.2008**

**KRYETARI I KOMUNËS**  
**Prof. dr. Isa Mustafa**